



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE BIO-MJEKËSORE

Nr 75 Prot
1

Tiranë, më 30/11 2023

URDHËR

Nr. 23 Datë 30. 11. 2023

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TE INTEGRITETIT TË QENDRËS KOMBËTARE TEKNIKE
BIO-MJEKËSORE 2023-2025”

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të Vendimit Nr.516, datë 01.07.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, për periudhën 2015-2020 dhe miratimin e Planit të veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Qendrës Kombëtare Teknike Bio-mjekësore 2023-2025, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ky urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare Teknike Bio-mjekësore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI

I KOMANDUAR NË DETYRË


Aldo Qejvani

QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE BIO-MJEKËSORE

PLANI I INTEGRITETIT

2023 - 2025

Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Komanduar të Qendrës Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore nr _____ Datë ____/ ____/ 2023

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Qendrën Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore :

1. Aldo Qejvani
2. Arian Boci
3. Vera Ndreu
4. Ismail Garipi
5. Suada Pervana

SHKURTESA DHE AKRONIME

QKTB	QENDRA KOMBËTARE TEKNIKE BIO-MJEKËSORE
BNJ	BURIME NJERËZORE
GPI	GRUPI I PUNËS PËR INTEGRITETIN
AKSHI	AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
PI	PLANI I INTEGRITETIT
MSHMSH	MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
USAID	UNITED STATES AGENCY FOR INTERNATIONAL DEVELOPMENT
ITeHP-AL	PROGRAMI I INTEGRUAR I TELEMJEKËSISË DHE E-HEALTH I SHQIPËRISË
PITSHE-SH	PROGRAMI I INTEGRUAR I TELEMJEKËSISË DHE SHËNDETIT ELEKTRONIK I SHQIPËRISË
HD	HIGH DEFINITION

Përmbajtje

1. Rëndësia e planit të Integritetit.....	6
1.1 Metodologjia.....	7
1.2 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit në QKTB.....	7
2. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit.....	9
3. Plan veprimi për menaxhimin e riskut të integritetit.....	13
Objektivi 1 : Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional për realizimin e funksioneve të QKTB me qëllim forcimin e etikës dhe integritetit në institucion.....	13
Objektivi 2 : Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të përmirësuar standardet e shërbimeve të ofruara nga QKTB.....	15
Objektivi 3 : Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies institucionale të QKTB-së	16
Objektivi 4 : Përmirësimi i kapaciteteve teknike në sektorin e riparim mirëmbajtjes në QKTB.....	17
Objektivi 5 : Përmirësimi i shërbimeve të standardeve më të mira të menaxhimit dhe asistencës në infrastrukturat biomjekësore në përputhje me rekomandimet dhe direktivat e KE dhe ofrimi i një niveli të lartë kompetence në fushën e inxhinierisë klinike	18

1. Rëndësia e planit të Integritetit

Përballja efektive me korrupsionin për Qendrën Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për të gjitha institucionet publike shëndetësore të Republikës së Shqipërisë. Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore, është një institucion nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka si qëllim të saj mbështetjen e të gjithë strukturave të sistemit shëndetësor publik për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, si dhe ofrimin e një niveli të lartë kompetence në fushën e Inxhinierisë Klinike. Në këtë kuadër, objektivi kryesor është ofrimi i një shërbimi të standardeve më të mira ndërkombëtare të manaxhimit dhe mirëmbajtjes së teknologjisë mjekësore në përputhje edhe me rekomandimet dhe direktivat e KE, për të mundësuar që jo vetëm pajisjet mjekësore të jetojnë gjatë në kushte pune, por të garantojë siguri për pacientët, përdoruesit dhe të tjerët.

Për t'i shërbyer interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore ka hartuar planin e integritetit. Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion. Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Qendrës Kombëtare Teknike Bio-mjekësore të dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të shërbimit për të gjitha strukturat e sistemit shëndetësor publik. Ky plan Integriteti do të shërbejë si një instrument për menaxhimin e integritetit të institucionit, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e të gjitha strukturave të sistemit shëndetësor publik tek ne.

Ky Plan Integriteti do sjellë përmirësime të rëndësishme në sistemin e qeverisjes së mirë në Institucion dhe më konkretisht në drejtim të:

- Përmirësimin të kuadrit të brendshëm rregullator të QKTB në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit: Kodi i Etikës dhe rregulloret e brendshme të institucionit do të përmirësohen në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- Forcimin e burimeve njerëzore duke bërë që administratë të karakterizohet nga etika dhe integriteti dhe forcimi i përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet e drejtimit;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të standardeve më të mira ndërkombëtare të manaxhimit dhe mirëmbajtjes së teknologjisë mjekësore në përputhje edhe me rekomandimet dhe direktivat e KE
- Përmirësimin e stadarteve të aksesit në informacionin publik në Qendrën Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore, me qëllim rritjen e transparencës.

1.1 Metodologjia

Në procesin e hartimit të Planit të integritetit në Qendrën Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore janë përdorur dy metoda kryesore për të analizuar dhe vlerësuar cënueshmërinë e integritetit: metoda cilësore dhe ajo sasore. Në metodën cilësore përfshihej analizën e kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik të Qendrës Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore (shqyrtim literature), ku përfshihen strategjitë dhe dokumente politikash, rregulloret dhe aktet e brendshme, urdhra dhe manuale. Gjithashtu, u hulumtuan raporte të ndryshme për veprimtarinë e QKTB si përmbledhja e praktikave më të mira të Integritetit. Me tej, u krye analizimi i të dhënave nga diskutimi në fokus-grupe me punonjësit e sektorëve teknike dhe atyre mbështetëse të institucionit. Diskutimet në grupe të fokusuara dhe intervistat gjysmë të strukturuar, shërbyen për të identifikuar ngjarje negative në realizimin e proceseve të punës, praktika pune dhe pozicione pune, të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit, sjelljeve joetike e joprofesionale, si dhe parregullësi të tjera.

Metoda tjetër e përdorur ishte ajo sasore për vlerësimin e çështjeve të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion me anë të pyetësorit të strukturuar. Kjo metodë është zbatuar dhe administruar nga stafi i QKTB. Pyetësi është një instrument shumë i rëndësishëm për mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të kuantifikuara të risqeve të integritetit për aspekte të veçanta të integritetit në këtë institucion publik. Në pyetësin e vlerësimit trajtohet niveli i zbatimit të ligjit, procedurat e rekrutimit, vlerësimi i performancës së stafit, njohuritë dhe zhvillimi profesional, komunikimi i brendshëm si dhe roli i njësive të QKTB-së. Punonjësit e QKTB plotësuan një pyetësor në mënyrë anonime, për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të integritetit në institucion. Në anketim u përfshi një kampion me 22 punonjës të institucionit me një nivel besueshmërie statistikore 85%. Shkalla e vlerësuar e gabimit është +/- 7%. Kampioni karakterizohej nga një shpërndarje e gjerë për sa i përket gjinisë, moshës dhe vjetërsisë në punë. Të anketuarit burra/djem përbëjnë 59% të kampionit krahasuar me punonjëset gra/vajza që janë 40.9%. Punonjësit e moshës 46-55 vjeç kanë përqindjen më të madhe në kampion me 32%. Edhe të intervistuarit në moshë 36-45 vjeç janë të përfaqësuar mirë dhe përbëjnë 7.3% të kampionit. Kategoria e grup-moshës mbi 56 vjeç përfaqësojnë 23% të kampionit dhe ata të grup-moshës 26-35 vjeç përbëjnë 27% të kampionit. Vetëm 1.1% e punonjësve që kanë marrë pjesë në plotësimin e pyetësorit i përkasin kategorisë së grup moshës më pak se 25 vjeç. Të anketuarit me përvojë pune 21-30 vjet përbëjnë 13.6% të kampionit dhe kategoria me më pak përvojë pune (më pak se 5 vite punë) përbëjnë 27.2% të kampionit. Ndërkohë që kategoria me përvojë 5-10 vite pune përfaqësohen me 22.7% të kampionit, e ndjekur nga kategoria me 11-20 vite përvojë pune, kategori që përbën 22.7% të të gjithë kampionit. Dhe kategoria mbi 30 vjet pune 13.6% të kampionit.

1.2 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit në QKTB

Plani i Integritetit është rezultat i një analize gjithëpërfshirëse të planifikimit të integritetit dhe të vlerësimit të riskut të integritetit në QKTB realizuar gjatë periudhës gusht-dhjetor 2023. Në këtë proces u bë vlerësimi sipas fushave të veprimtarisë së institucionit: menaxhimi financiar dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; arkiva, ruajtja dhe administrimi i dokumenteve zyrtare; fusha të veçanta, si fusha e ofrimit të shërbimeve të standardeve më të mira ndërkombëtare të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së teknologjisë mjekësore në përputhje

edhe me rekomandimet dhe direktivat e KE; Sektori i riparim-mirëmbajtjes i cili mundëson përmbushjen e proceseve vlerësuese, ekzaminuese, testuese, proceset e ndërhyrjes drejt tentativave riparuese në një bashkëpunim të ngushtë me sektorin e inxhinierisë klinike në QKTB; Sektori i zhvillimit të infrastrukturës së Telemjekësisë në institucionet publike shëndetësore të Republikës së Shqipërisë, Telekonsultat dhe Bibloteka Elektronike.

Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore, është një institucion nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i cili në datën 01.01.1996 ka ndryshuar emërtimin nga Ofiçina Elektromjekësore në Qendrën Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore dhe ka si qëllim të saj mbështetjen e të gjithë strukturave të sistemit shëndetësor publik për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, si dhe ofrimin e një niveli të lartë kompetence në fushën e Inxhinierisë Klinike. Në këtë kuadër, objektivi kryesor është ofrimi i një shërbimi të standardeve më të mira ndërkombëtare të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së teknologjisë mjekësore në përputhje edhe me rekomandimet dhe direktivat e KE, për të mundësuar që jo vetëm pajisjet mjekësore të jetojnë gjatë në kushte pune, por të garantojë siguri për pacientët, përdoruesit dhe të tjerët

Pikërisht kjo veprimtari përbën bërthamën e funksionimit të QKTB-së dhe ka rol qendror në realizimin e misionit të këtij institucioni. Telemjekësia është themeluar vitin 2011 dhe në 01.01.2017 ka kaluar si sektor i Qendrës Kombëtare Teknike Bio-mjekësore duke ofruar një nivel të lartë standardizimi me zhvillimin e infrastrukturës së saj në të gjitha strukturat shëndetësore që ajo suporton në Republikën e Shqipërisë.

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Më qëllim hartimin e Planit të Integritetit Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore, me anë të urdhërit Nr.75 Prot., date 14/11/2023, ngriti grupin e punës, përfaqësues të sektorëve të ndryshme të institucionit dhe me koordinator Drejtorin e komanduar të QKTB i cili është me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inxhinierisë Klinike. Grupi i punës ka marrë të gjitha masat për zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet publike. Grupi i punës dhe punonjësit e tjerë të QKTB u njohën me qëllimin dhe objektivat e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, në një takim të përbashkët i cili gjithashtu përfshiu diskutime për konceptet kryesore si dhe procesin që duhet të ndiqet për të hartuar Planin e Integritetit. Ky takim u mbajt në fillim të procesit të hartimit të Planit të Integritetit dhe i shërbeu grupit të punës për të trajtuar disa nga çështjet dhe dinamikat kryesore të proceseve të punës së institucionit.

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit

Grupi i punës shqyrtoi kuadrin ligjor, rregullator dhe strategjik si dhe dokumente të ndryshme operative të Institutit. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion. Grupi i punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre për proceset e punës sipas departamenteve të institucionit. Në këtë fazë, grupi i punës analizoi të dhënat nga pyetësi për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit.

Pjesë e kësaj analize ishin edhe të dhënat cilësore të mbledhura nga grupet e diskutimit me punonjësit e departamenteve të qendrës. Në këtë fazë, grupi i punës analizoi të dhënat e përfutuara nga pyetësi për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, pyetësor i realizuar me punonjësit e qendrës. Anketimi u plotësua nga 22 punonjës të qendrës, të cilët e plotësuan pyetësorin në mënyrë anonime në format shkresor të cilët janë administruar nga grupi i punës.

Përmes këtij pyetësi u siguruan të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të integritetit në Qendrën Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore.

Faza 3: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe miratimi

Gjatë kësaj faze të procesit, grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit. Nga analiza e të dhënave rezultoi se qendra disponon dhe ka vënë në zbatim mekanizma për sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe parandalimin e rasteve të korrupsionit. Për këtë arsye, në planin e veprimit u inkadruan jo vetëm masa të reja kontrolli por në disa raste edhe përmirësimi i masave ekzistuese. Analiza e realizuar në fazën e mësipërme diktoi nevojën për të përmirësuar kuadrin rregullator të brendshëm dhe marrjen e masave për zhvillimin e burimeve njerëzore të qendrës përmes: forcimit të njësisë së sinjalizuesve, njohjes dhe zbatimit të rregullave për konfliktin e interesit dhe të etikës, aksesit në informacionin publik dhe konsultimin publik. Në këto masa përshkruhen aktivitetet që duhet të zbatohen për parandalimin, zvogëlimin apo eliminimin e rreziqeve të integritetit, jepen afatet kohore dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin e tyre. Për këtë arsye, në planin e veprimit u inkadruan jo vetëm masa të reja kontrolli por në disa raste edhe përmirësimi i masave ekzistuese.

2. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit

2.1 Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional për realizimin e funksioneve të QKTB me qëllim forcimin e etikës dhe integritetit në institucion

Me qëllim forcimin e mekanizmave të etikës dhe integritetit, Qendra do të angazhohet në përmirësimin e rregulloreve të brendshme ekzistuese për aspekte të veçanta të lidhura me etikën dhe integritetin apo dhe miratimin e rregullave të reja kur ato rezultojnë në mungesë me qëllim mirëfunksionimin e institucionit në të gjithat fushat e veprimtarisë.

Ndër të tjera, ky kuadër i përmirësuar rregullator do të mbulojë: rregullimin e mënyrës së raportimit dhe komunikimit të brendshëm ndërmjet sektorëve të institucionit veçanërisht në procese të lidhura pune. Gjithashtu, përpos nevojës për bashkëpunim më të ngushtë mes sektorëve të brendshme të QKTB kryesisht Sektori i Inxhinierisë Klinike me Sektorin e Riparim Mirëmbajtjes, është diktuar dhe adresimi i nevojës për bashkëpunimin dhe ndërveprimin edhe me institucione apo struktura të tjera me fokuse të ngjashme si p.sh., institucionet publike shëndetësore të Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale etj.

Garantimi i shërbimit teknike mbi pajisjet mjekësore nga QKTB në një tërësi aktivitetesh teknike në sekuencë ndaj pajisjeve mjekësore duhet caktuar qartë prioriteti referuar rëndësisë dhe problematikave të mundshme si pasojë referuar pajisjeve mjekësore në rang institucional dhe territorial.

Forcimi i integritetit institucional synohet të arrihet nëpërmjet përmirësimit dhe informimit periodik të stafit të QKTB për politikat, rregullat dhe procedurat që synojnë të trajtojnë konfliktin e interesit, dhuratat dhe përfitimet e tjera të çdo lloji, interesat e tjera të deklarueshme, veprimtaritë e jashtme, zbatimin e kodit të etikës në punë, apo edhe privatësinë dhe konfidencialitetin. Qendra angazhohet se do të sigurojë respektimin e parimeve të etikës nga punonjësit e institucionit, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për konfliktin e interesave, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe rregullave të etikës në administratën publike. Për këtë qëllim, rishikimi i Kodit të Etikës do të fokusohet në përfshirjen e vlerave

organizative, standardet e sjelljes së mirë, modelin e lidhshimit të institucionit dhe qëndrimet dhe sjelljet e punonjësve.

Mbrojtja e sinjalizuesve është gjithashtu e rëndësishme si një mekanizëm efektiv i mbikëqyrjes publike. Promovimi i mbrojtjes së sinjalizuesve është me rëndësi për një administratë publike cilësore, të paanshme, efektive që bazohet në parimet e integritetit dhe objektivitetit. Qendra angazhohet të ndërgjegjësojë dhe të informojë më tej dhe në mënyrë periodike punonjësit e tij për procedurat ligjore në lidhje me sinjalizuesit dhe mbrojtjen e tyre, në mënyrë që këta të fundit ta kenë më të lehtë denoncimin e shkeljeve dhe sjelljeve të dënueshme në përputhje me procedurat ligjore.

2.2 Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të përmirësuar standardet e shërbimeve të ofruara nga QKTB

Në drejtim të përmirësimit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, Qendra angazhohet a të zbatojë në mënyrë objektive legjisllacionin në fuqi për rekrutimin e punonjësve dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me qëllimin final krijimin e një administrate profesionale dhe të qëndrueshme. Përveç kësaj, do të bëhen përpjekje për të forcuar një politikë të menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila do të bazohet në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritokracisë, transparencës dhe profesionalizmit. Një element i rëndësishëm për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore është edhe ngritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të institucionit si në aspektin teknik ashtu edhe atë të etikës dhe integritetit nëpërmjet një plani vjetor të trajnimeve. Punonjësit e sektorëve të qendrës kryesisht të sektori të Inxhinierisë Klinike dhe sektorin të Riparim Mirëmbajtjes, kryejnë trajnime teknike si dhe kryejnë shkëmbimin e informacionit sensitiv dhe të vlefshëm teknik drejt mirëmbajtjes së aseteve biomjekësore në nivel të lartë mirëbesimi. Për çdo problem apo informacion QKTB ofron asistencë dhe trajnime në lidhje me aplikimin apo përdorimin në sistemin Clingo platformë e programit të Inventarizimit dhe monitorimit të pajisjeve mjekësore duke kryer regjistrimin e pajisjeve të reja dhe shënimin e ndërhyrjeve teknike bazuar në menaxhimin e pajisjeve aktuale për të gjitha institucionet publike shëndetësore të Republikës së Shqipërisë. Por vetë personeli teknik i QKTB trajnohet pak, pasi Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore asiston në raste defektesh gjithmonë bazuar në kërkesa institucionale referuar pajisjeve të ndryshme mjekësore. Ndërhyrjet kundrejt pajisjeve konsistojnë në procese vlerësuese, ekzaminuese, testuese dhe riparimi, dhe ky personel teknik nuk i disponon trajnimet, informacionin teknik si skema, diagrama teknike, udhëzuesin e shërbimeve si dhe asistencën bazuar në protokollet e prodhuesit drejt performimit të ‘troubleshooting’ si dhe nuk disponon pjesë këmbimi apo komponentë zëvendësues referuar kompozimit të sistemeve imazherike përkatëse. Në këtë kuadër, QKTB angazhohet për miratimin e një plani të mirëfilltë trajnimesh të përcaktuar për personelin teknik të qendrës.

2.3 Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies institucionale të QKTB-së

Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore si një institucion nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale profilizuar në fushën e mbështetjes së të gjithë strukturave të sistemit shëndetësor publik për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, si dhe ofrimin e një niveli të lartë kompetence në fushën e Inxhinierisë Klinike. Në këtë kuadër, objektivi kryesor është ofrimi i një shërbimi të standardeve më të mira ndërkombëtare të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së teknologjisë mjekësore në përputhje edhe

me rekomandimet dhe direktivat e KE, për të mundësuar që jo vetëm pajisjet mjekësore të jetojnë gjatë në kushte pune, por të garantojë siguri për pacientët, përdoruesit dhe të tjerët.

Transparenca e Qendrës gjatë këtyre proceseve është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të interesit në sektorin e gjithë strukturave të sistemit shëndetësor publik. Gjithashtu, Qendra do të mbështesë ofrimin e informacionit publik duke përmirësuar dhe përditësuar në mënyrë të vazhdueshme Programin e Transparencës.

2.4 Përmirësimi i kapaciteteve teknike në sektorin e riparim mirëmbajtjes në QKTB

Sektori i riparim-mirëmbajtjes mundëson përmbushjen e proceseve vlerësuese, ekzaminuese, testuese, proceset e ndërhyrjes drejt tentativave riparuese në një bashkëpunim të ngushtë me sektorin e inxhinierisë klinike në QKTB. Gama e pajisjeve ndaj të cilave personeli teknik aplikon aktivitetin teknik është e gjerë duke përfshirë pothuaj se çdo lloj pajisjeje apo sistem, mekanizëm biomjekësor në terrenet spitalorë publikë përkatës, që nga hapësirat laboratorike (fotometër, analizator etj) e deri në infrastrukturat komplekse imazherike (sistem grafi, skopi, grafi-skopi etj). Përgjatë veprimtarisë dhe detyrave funksionale të personelit në sektorin e riparim mirëmbajtjes, stafi ndeshet me problematika të cilat i përkthen edhe në sfida apo objektiva të cilat synojnë një reagim apo kundërveprim në favor të punës dhe në dobi të QKTB si dhe institucioneve publike shëndetësore.

2.5 Përmirësimi i shërbimeve të standardeve më të mira të menaxhimit dhe asistencës në infrastrukturat biomjekësore në përputhje me rekomandimet dhe direktivat e KE dhe ofrimi i një niveli të lartë kompetence në fushën e inxhinierisë klinike.

Sektori i inxhinierisë klinike bashkëpunon ngushtë me sektorin e riparim-mirëmbajtjes duke përforcuar kapacitetet teknike në lidhje me proceset vlerësuese, ekzaminuese, testuese drejt tentativave riparuese mbi pajisjet mjekësore në institucionet publike shëndetësore. Personeli i inxhinierisë klinike asiston ndjeshëm personelin teknik duke i vendosur në dispozicion informacion teknik si manuale përdorimi, manuale teknikë, informacione si dhe orientime “remote” në kohë reale përgjatë aktivitetit teknik duke favorizuar proceset “troubleshooting” drejt riparimit të aparaturave mjekësore.

Sektori i inxhinierisë klinike asiston dhe ndjek procesin e inventarizimit fizik dhe elektronik (sistemi Clingo) referuar pajisjeve mjekësore në institucione shëndetësore publike. Nëpërmjet trajnimit “remote”, fizik dhe kolektiv, personeli i inxhinierisë klinike orienton personelin përfaqësues nga institucionet publike shëndetësore drejt aplikimit të sistemit elektronik (Clingo) drejt krijimit të raporteve si dhe manaxhimit e rekordeve mbi aparaturat mjekësore.

Sektori i inxhinierisë klinike mundëson konsulencë në lidhje me kapacitetet teknike të pajisjeve biomjekësore të synuara në institucione shëndetësore publike. Gjithashtu ofron asistencë edhe duke u bërë pjesë e grupeve të punës në procese monitorimi dhe vlerësimi duke synuar arritjen e objektivave institucionale në terrene të ndryshme.

Përgjatë veprimtarisë dhe detyrave funksionale të personelit në sektorin e inxhinierisë klinike, stafi ndeshet me problematika të cilat i përkthen edhe në sfida apo objektiva të cilat synojnë


një reagim apo kundërveprim në favor të punës dhe në dobi të QKTB si dhe institucioneve publike shëndetësore.

Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të trajtuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit, të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së qendrës. Në të jepen përshkrime për aktivitete të veçanta që do të zbatohen për të arritur katër objektivat e Planit të Integritetit. Zbatimi i Planit të Integritetit do të pasohet nga procesi i raportimit dhe monitorimit.

Raportimi është një procedurë e rregullt, që siguron zbatimin e Planit të Integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për të ndjekur ecurinë e zbatimit. Raportimi duhet të bëhet të paktën brenda një periudhe gjashtëmujore.

Monitorimi i Planit të Integritetit është periodik (çdo vit) dhe pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve, përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të. Nga monitorimi do të përcaktohet nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikase, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e vetë planit. Pas monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit, grupi i punës së institutit do të rishikojë dokumentin dhe do ta përditësojë atë me sfidat e ardhshme. Raporti vjetor për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit do të publikohet në faqen e QKTB-së.



3. Plan veprimi për menaxhimin e riskut të integritetit
për realizimin e funksioneve të QKTB me qëllim forcimin e etikës dhe integritetit në institucion

Objektivi 1 : Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional

Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut (Burimi i rrezikut/ Lloji i ndikimit)	Rreziku i brendshëm	Kontrolli (rekomandimet)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
1.	Në përputhje me Urdhrin nr. 31, datë 05.12.2024, është miratuar Plani për Kodin e Etikës për QKTB.	Veprimtaria/ reputacioni dhe imazhi i institucionit	I lartë	1. Në zbatim të Urdhrit nr. 31, datë 05.12.2024, është hartuar dhe miratuar Kodi i Etikës për QKTB, i cili përcakton rregullat për dhuratat, donacionet, sponsorizimet dhe shpenzimet e mbuluara nga të tretë, me zbatim për të gjithë punonjësit e institucionit. 2. Informimi / trajnimet të personelit të brendshëm në lidhje me kodin e etikës.	1. Grupi teknik i punës, 2. Specialisti i Burimeve Njerëzore 1. Gjashtëmujori i dytë 2024 dhe në vazhdimësi 2. Gjashtëmujori i dytë 2024 dhe në vazhdimësi

2	Mospërditësim i sistemit të të dhënave të burimeve njerëzore për institucionin.	Operacional	Mesatar	1. Popullimi i sistemit të të dhënave (sistemi HRIMS) me të dhënat e burimeve njerëzore (në bashkëpunim me AKSHI-në dhe DAP-in).	1. Burimet Njerëzore 1. gjashtëmuji i parë 2024
3	Njohuri të kufizuara të punonjësve për: rregullat e etikës, konfliktit të interesit, deklarin e dhuratave, veprimtarive të jashtme, të drejtën për informim dhe kufizimet e saj, të dhënat personale .	Veprimtaria/ reputacioni dhe imazhi i institucionit	Mesatar	1. Përfshirja e personelit tonë gjatë zhvillimit të temave të trajnimit të këtyre çështjeve në ASPA	1. Përditësimi i planit vjetor të trajnimeve – BNJ 1. gjashtëmuji i dytë 2024
4	Njohuri të kufizuara të punonjësve për rregullat e komunikimit brenda institucionit.	Veprimtaria	Mesatar	1 Informim periodik për rregullat e komunikimit, formatet e komunikimit, dhe etikën e komunikimit. 2. Ruajtja e të gjitha formateve të shkresave/memove, akteve etj., që përdoren nga institucioni në një hapësirë të përbashkët interneti të aksesueshme nga çdo punonjës.	1. Specialisti i Burimeve Njerëzore 2. Personi përgjegjës për arkivin 1 Gjashtëmuji i parë 2024 dhe ne vijim 2. Gjashtë muji i parë 2024

Objektivi 2 : Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të përmirësuar standardet e shërbimeve të ofruara nga QKTB

Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut (Burimi i rrezikut/ Lloji i ndikimit)	Rreziku i brendshëm	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
5	Plani vjetor i trajnimeve duhet përditësuar me nevojat sipas strukturës së institucionit.	Veprimtaria/ reputacioni	Mestar	1.Të përditësohet plani gjithëpërfshirës i trajnimeve ku të përfshihen trajnimet e ofruara nga ASPA, webinar-e online dhe forma të tjera për trajnim specialistësh të riparim mirmbajtjes dhe inxhinierisë klinike..	1.Specialisti i Burimeve Njerëzore 1. Gjashtëmujori i dytë 2024
6	Prani e sjelljeve joetike dhe joprofesionale ndërmjet kolegëve.	Veprimtaria	Mesatar	1. BNJ të identifikojë, e të realizojë kontrole të brendshme për të identifikuar tërësinë e sjelljeve jo-etike dhe jo- profesionale dhe marrjen e masave përkatëse. 2. Në vijim të hartohet dhe miratohet një pyetësor për vlerësimin periodik të sjelljeve jo etike dhe jo profesionale në institucion. 3. Të kryhet një analizë të gjetjeve sipas pyetësorëve	1. Specialisti i Burimeve Njerëzore 2. Specialisti i Burimeve Njerëzore 3. Specialisti i Burimeve Njerëzore 1. Gjashtëmujori i dytë 2024 2. Gjashtëmujori i dytë 2024 3. Gjashtëmujori i dytë 2024

Objektivi 3 : Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies institucionale të QKTB-së

Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut (Burimi i rrezikut/ Lloji i ndikimit)	Rreziku i brendshëm	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
7	Rubrikat e programit të transparencës në QKTB paraqesin mangësi në publikimin e informacionit pa kërkesë.	Ligjor / Imazhi	Mesatar	1.Përditësimi i programit të transparencës së institucionit dhe plotësimi me informacionin e nevojshëm publik.	1.Koordinatori për të drejtën për informim + drejtuesit e departamenteve të QKTB-së. 1.Gjashtëmujori i parë i 2024.

Objektivi 4 : Përmirësimi i kapaciteteve teknike në sektorin e riparim mirëmbajtjes në QKTB

Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut (Burimi i rrezikut/ Lloji i ndikimit)	Rreziku i brendshëm	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
9	Ngarkesë e lartë e sektorit të riparim-mirëmbajtjes dhe nevojat për organizimin e proceseve të punës dhe manaxhimit të risqeve.	Veprimtaria	Mesatar	1. Në një tërësi aktiviteteve teknike në sekuençë ndaj pajisjeve mjekësore duhet caktuar qartë prioriteti referuar rëndësisë dhe problematikave të mundshme si pasojë referuar pajisjeve mjekësore në rang institucional dhe territorial. 2. Të sigurohen kapacitetet teknike për realizimin e proceseve “multitasking” në paralel në dobi të aktivitetit teknik biomjekësor.	1. Përgjegjësi i sektorit të riparimit dhe mirëmbajtjes QKTB në bashkëpunim me personelin teknik QKTB. 1. Gjashtëmujori i parë 2024. 2. Përgjegjësi i sektorit të riparimit dhe mirëmbajtjes QKTB në bashkëpunim me personelin teknik QKTB. 2. Gjashtëmujori i parë 2024.
10	Disponibilitetit i stafit teknik në emergjencë duhet përforcuar për shkak të kërkesave të shumta nga institucionet shëndetësore publike në terren.	Veprimtaria	Mesatar	1. Të sigurohen kapacitetet teknike drejt menaxhimit të emergjencave duke garantuar gadishmëri dhe efikasitet. Elementë të tillë kërkojnë ndërprerjen e menjëhershme të aktivitetit teknik në favor të përgjigjes në kohë reale të personelit teknik QKTB duke shfrytëzuar kapacitetet disponibël teknike.	1. Përgjegjësi i sektorit të riparimit dhe mirëmbajtjes QKTB në bashkëpunim me personelin teknik QKTB. 1. Gjashtëmujori i parë 2024 dhe në vazhdimësi.

11	Informimi i personelit teknik të QKTB-së me kapacitetet ligjore / politikat në lidhje me pajisjet mjekësore	Veprimtaria	Mesatar	1. Personeli teknik duhet të njohë pikat më të rëndësishme referuar aktivitetit teknik mbi pajisjet mjekësore drejt një bashkëpunimi legjitim dhe efikas midis QKTB dhe institucioneve të tjera shëndetësore publike.	1. Përgjegjësi i sektorit të riparimit dhe mirëmbajtjes QKTB në bashkëpunim me personelin teknik QKTB. 1. Gjashtëmujori i parë 2024 dhe në vazhdimësi.
----	---	-------------	---------	---	---

Objektivi 5 : Përmirësimi i shërbimeve të standardeve më të mira të menaxhimit dhe asistencës në infrastrukturat biomjekësore në përputhje me rekomandimet dhe direktivat e KE dhe ofrimi i një niveli të lartë kompetence në fushën e inxhinierisë klinike.

Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut (Burimi i rrezikut/ Lloji i ndikimit)	Rreziku i brendshëm	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
12	Sistemi i centralizuar ArkimeDo21 për menaxhimin dhe inventarizimin elektronik të pajisjeve mjekësore është funksional dhe mundëson gjenerimin e të dhënave në mënyrë të rregullt.	Ligjor / Imazhi	Mesatar	1. Trajnimi i vazhdueshëm i përdoruesave fundorë në institucionet shëndetësore publike. 2. Monitorim i veprimtarisë së inventarizimit elektronik nëpërmjet sistemit aktual dhe komunikimeve të vazhduara	1. Sektori i inxhinierisë klinike QKTB 2. Sektori i inxhinierisë klinike QKTB 1. Gjashtëmujori i parë i 2024. 2. Gjashtëmujori i parë i 2024.

13	Informimi i personelit inxhinierik të QKTB-së me kapacitetet ligjore / politikat në lidhje me pajisjet mjekësore	Veprimtaria	Mesatar	1. Personeli inxhinierik duhet të njohë pikat më të rëndësishme referuar aktivitetit teknik mbi pajisjet mjekësore drejt një bashkëpunimi legjitim dhe efikas midis QKTB dhe institucioneve të tjera shëndetësore publike.	1. Përgjegjësi i sektorit të inxhinierisë klinike QKTB 1. Gjashtëmuji i parë 2024 dhe në vazhdimësi.
14	Adaptimi me teknologjinë inovative dhe atë bashkëkohore	Veprimtaria	Mesatare	1. Pjesëmarrje në trajnime / webinarë referuar disiplinave të teknologjisë në kujdesin shëndetësor	1. Përgjegjësi i sektorit të inxhinierisë klinike 1. Gjashtëmuji i parë 2024 dhe në vazhdimësi.